

#SHSSH

#Punojmë çdo ditë për të qenë afër njerëzve në nevojë

Drejtoresha e përgjithshme znj. Luneda Sufali solli në vëmendje një nga rastet e shumta ku #SHSSH punon për të menaxhuar në kohë reale rastet. Ky është një nga rastet e suksesshme ku vajza me inicialet D.B mori shërbimin e nevojshëm.

Sapo rasti u raportua, nga Drejtoria Rajonale e SHSSH-së Vlorë, u morën menjëherë masa për të bërë vlerësimin social-ekonomik gjatë së cilit u konstatua se:

- Vajza ishte e braktisur nga të dy prindërit, jetonte me gjyshërit dhe kishte probleme të rënda shëndetësore (probleme me shtyllën kurrizore).
- U punua maksimalisht për t'i lidhur pagesën e aftësisë së kufizuar, si një e drejtë e mohuar prej vitesh për shkak të burokracirave ligjore lidhur me tërheqjen e pagesës në mungesë të prindërve.
- Aktualisht po punohet që vajza të përfitojë grupin e parë të invaliditetit, ashtu si e parashikon ligji. Së bashku me mësuesen e vogëlushes, po mbahet kontakt me mjekët pranë QSUT-së, për të mbyllur procedurat e nevojshme për pajisjen me Fletën e Drejtimit për Kemp dhe për të mundësuar shansin për një ndërhyrje kirurgjikale.


#Shërbimet Sociale

Drejtorja e Shërbimeve Sociale gjatë këtij muaji ka monitoruar rastin e një të moshuari në Shtëpinë e të Moshuarve Poliçan ku dhe është mbyllur raporti për këtë monitorim.

Eshtë mbyllur raporti i të dhënave për 3 mujorin e Task Forcës së PAK.

Eshtë riparë konventa për të drejtat e Fëmijëve 2002-2018.

#Drejtorja e Kontrollit të pagesës NE & PAK



Gjatë këtij muaji janë zhvilluar kontrole nga drejtoritë e ndryshme rajonale sipas planit të punës 2018.

Këto kontrole janë ushtruar nga drejtoritë tona rajonale në Njësitë Administrative të qarqeve respektive.

Nga kontrollet e ushtruara u lanë rekomandimet e tyre.



SHERBIMI SOCIAL

#IPSH

#Fëmijët të parët



Gjatë muajit Gusht, ne nuk u kujdesëm që fëmijët të shkojnë vetëm në plazh, por të shohin dhe argëtohen edhe në mënyra të tjera. Fëmijët e QKTE kaluan një ditë ndryshe pranë Shkollës së Qenëve ku fëmijët u njohën nga afër me trajnimet dhe mësimet që marrin qenë të ndryshëm.